



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

*Data: 10.06.2022*

Drejtuar: JUBICA.” shpk me NUIS K26529001I me adresë Rruga Luigj Gurakuqi, Kuklejt, nr 108 , Shkodër.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: E hapur, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 mujor.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-26019-04-21-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Sinjalistike vertikale (tabela, tuba, atrecature)”, me afat lëvrimi nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas kërkesës, në bazë të marrëveshjes kuadër, me fond limit 14,175,150 (katërmbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike Datë 26.04.2022, Numri 53

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori ekonomik " I.D.K - KONSTRUKSION" shpk me NUIS K51408016J me adresë Autostrada Tirane-Durres, Km.12, Rruga Zaja, Koder Bexulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167 Vore, Tiranë dhe me ofertë ekonomike 13.843.500 (trembëdhjetë milion e tetëqind e dyzet e tre mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik "JUBICA." shpk me NUIS K26529001I me adresë Rruga Luigj Gurakuqi, Kuklejt, nr 108 , Shkoder, dhe me ofertë 8.732.100 (tetë milion e shtatëqind e tridhjet e dy mijë e njëqind) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik " R. S. & M " shpk me NUIS K32203002I me adresë Autostrade Km 2, Tirane dhe me ofertë ekonomike 8.508.725 (tetë milion e pesëqind e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekë pa tvsh.
4. Operatori ekonomik R.S.M Company me Nr.Biznesi 810802422 me seli qendrore Cagllavice Prishtinë dhe me degë të shoqërisë të huaj në Tiranë,Shqiperi me NIPT L 04803001 U me adresë Rruga Xhorxh Martini dhe me ofertë 3.146.350 (tre milion e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjet) lekë pa tvsh.
5. Operatori ekonomik "Sings & Road Safety Solutions" me NUIS L 622228020 U dhe me ofertë 10.631.594 (dhjetë milion e gjashtëqind e tridhjet e një mijë e pesëqind e nëntëdhjet e katër) lekë pa tvsh

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

**1.Nga shqyrtimi i ofertes të paraqitur ne SPE të Operatorit Ekonomik"R. S. & M " shpk me NUIS K32203002I u konstatua se:**

1. I plotëson kërkesat e pergjithshme për kualifikim.
2. Nuk plotëson kriteret e vecanta per kualifikim si më poshtë:
  - Nuk përmbush pikën 2.1 gërma a) të KRITEREVE TE VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT ku parashikohet se: *"1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8"*  
Operatori ka deklaruar (plotësuar) gabim piken 3 të seksionit A **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT** ku parashikohet se: *Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.* Pasi O.E nuk ka deklaruar të dhënat e Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik .
3. Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka gabime aritmetik.
4. Totali i ofertës 8.508.725 (tetë milion e pesëqind e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekë pa tvsh.
5. Nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash nga kjo shoqëri.

**2.Nga shqyrtimi i ofertës të paraqitur në SPE të Operatorit Ekonomik “R.S.M Company” me Nr.Biznesi 810802422 dhe NIPT L04803001U u konstatua se:**

1. I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
2. Nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim si më poshtë:
  - Nuk përmbush pikën 2.3.4 të Kapaciteti teknik ku parashikohet se: *Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e materialeve të pasqyruara në tabelën e mëposhtme, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik në datën dhe orën e hapjes së ofertave. **Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s’kualifikim.***

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Tabelë F.2</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
<i>2</i>	<i>Tabele F75</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
<i>3</i>	<i>Model 6/m</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
<i>4</i>	<i>Tabelë F.303 (Kalim këmbësorësh) 60x60, Cl.II</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
<i>5</i>	<i>Tabele F309</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
<i>6</i>	<i>Tub sinjalistike me H=3.3ML</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
<i>7</i>	<i>Pasqyra</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>

Pasi O.E në datën dhe orën e përcaktuar në DST ka paraqitur mostrat e kërkuara përveç artikullit Nr.7 pasqyrë.

3. Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka gabime aritmetik por ka mospërputhje të shumës totale midis : Shtojca 1: “Formulari i ofertës” dhe Shtojca 2: “ Lista e çmimeve të artikujve”
4. Totali i ofertës 3.146.350 (tre milion e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjet) lekë pa tvsh.
5. Nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash nga kjo shoqëri.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si i suksesshëm:

1. Operatori ekonomik “JUBICA.” shpk me NUIS K26529001I me adresë Rruga Luigj Gurakuqi, Kuklejt, nr 108 , Shkoder, dhe me ofertë 8.732.100 (tetë milion e shtatëqind e tridhjet e dy mijë e njëqind) lekë pa tvsh.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**